

PËRTEJ REFRAKTARITETIT – PSIKOTERAPIA PËRMES INTERNETIT SI NJË MUNDËSI

Dr.sci. Naim Fanaj¹ & Ma.sc. Sevim Mustafa²

¹ QSHM-SHIB, Prizren

² Asistente Projektit IMPLEMENTALL

Hyrje

Refraktariteti në kuptim të gjerë ka të bëjë me rezistencën në reagimin në trajtimin e aplikuar për një çrregullim. Në refraktaritet ndikojnë ndër të tjera: vonesa në marrjen e trajtimit dhe mosbashkëpunimi me trajtimin. Fusha e zgjerimit të shpejtë të këshillimeve online ka ngjallur shumë diskutime në mesin e mjekëve. Qëllimi i këtij hulumtimi është shqyrtimi i literaturës për psikoterapië përmes internetit si dhe njohja me qëndrimet e psikiatërve/psikologëve në Kosovë/Shqipëri ndaj saj.

Metodologjia

Është një punim i kros-seksional sasior. Pyetësi është hartuar me anë të Google forms dhe linku për plotësim është dërguar me email tek anëtarët e LPSH-së dhe APK-së. Janë vetëm 19 profesionistë që janë përgjigjur online. 12 psikiatër, 6 psikolog dhe një respondentë nuk e kanë cekur profesionin.

Rezultatet

36.8 % nuk kanë njohuri për internet psikoterapië. 84.2 % deklarohen se duhet ta aplikojmë. 10.5 % nuk janë të gatshëm ta aplikojnë. Gati gjysma (47.4 %) e shohin si penguese që ta aplikojnë mungesën e trajnimit. 52.6 % e shohin si lehtësim të punës. 52.6 % e pranojnë si të dobishme për pacientët me depresion. Si arsye penguese që pacientët të mos e pranojnë në 35 % të rasteve përmendet vlerësimi më tepër i kontaktit direkt me terapistin dhe 30 % mospasja qasj në internet/kompjuterë.

Përfundimet

Studimet sugjerojnë se internet psikoterapia mund të jetë efektive dhe ka përparësitë sidomos në shtimin e numrit të pacientëve që marrin trajtim. Profesionistët në Kosovë/Shqipëri treguan interesim të vogël për pjesëmarrje në hulumtim. Përkundër njohurive të vogëla pjesëmarrësit e mirëpresin këtë lloj psikoterape si një mundësi shtesë për dobini e pacientëve.

Fjalë kyqe: refraktariteti, internet psikoterapia, psikiatrit/psikologët, Kosovë, Shqipëri

BEYOND REFRACTORITY – INTERNET PSYCHOTHERAPY AS AN OPORTUNITY

Background

Refractority broadly refers to resistance to the reaction in the treatment applied to a disorder. In refractory cases there are also factors as: delay in treatment and non-cooperation with treatment. The area of rapid expansion of online counseling has sparked many discussions among doctors. The purpose of this research is to review the literature on internet psychotherapy and to know the attitudes of psychiatrists / psychologists in Kosovo / Albania towards her.

Methodology

It is a quantitative cross-sectional study. The questionnaire was drafted via Google forms and the link for completion was emailed to LPSH and APK members. There are only 19 professionals who have responded online. 12 psychiatrists, 6 psychologists and one respondent didn't mention the profession.

Results

36.8% have no knowledge about internet psychotherapy. 84.2% declare that we have to apply. 10.5% are not willing to apply. Nearly half (47.4%) see it as barrier to apply the lack of training. 52.6% see it as relief in professional work. 52.6% recognize it as beneficial for depressed patients. As a barrier factor for patients not to accept - in 35% of cases stated the need for more direct contact with the therapist and in 30% lack of access to internet / computers is mentioned.

Conclusions

Studies suggest that internet psychotherapy can be effective and has the advantages, especially in increasing the number of patients receiving treatment. Professionals in Kosovo / Albania showed little interest in participating in the research. Despite the little knowledge, participants welcome this kind of psychotherapy as an additional opportunity for the patients' benefit.

Key words: refractory, internet psychotherapy, psychiatrist / psychologists, Kosovo, Albania